



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 26.10.2023

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit 595, datë 7.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Çela
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, si dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar parashtrimeve me shkrim të depozituar në seancën e datës 28.9.2023, pasi vlerësoi aktet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas riçeljes së hetimit gjyqësor nga ana e Kolegjit, për secilin shkak ankimi, vlerëson sa më poshtë:

### **1. Lidhur me shkakun ankimor mbi pasurinë e paluajtshme Apartament me sipërfaqe 91,91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sipërfaqe 91 m<sup>2</sup>”)**

1.1 Për sa i përket *pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, mbeti e provuar se investimi i subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri është në shumën 57.250 euro ose 78% e vlerës së investimit. Sa më sipër provohet me: (i) mandatin e depozitimit të kësaj shume në cash nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela, në llogari të kompanisë “\*\*\*” sh.p.k., pranë \*\*\* Bank, me përshkrim transaksioni për shumën 57.250 euro, “Çela Arbër, blerje apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2013. Burimi i deklaruar i fondeve: kursime + hua” dhe (ii) mandatin e depozitimit në cash nga \*\*\*. \*\*\*, në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., pranë \*\*\* Bank, në vlerën 16.278 euro, më datë \*\*\*.5.2013, me përshkrim transaksioni: “\*\*\* \*\*\*, likuidim total i apartamentit rep. \*\*\* kol. \*\*\*. Kursime të ardhura + huamarrje”.*

1.1.1 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij shkak ankimi, as në prapësimet e tij në seancat e zhvilluara në Kolegj në datat 28.9.2023 dhe 4.10.2023. Akti i paraqitur nga subjekti lidhur me këtë shkak ankimi, shkresa nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2023, e

\*\*\* Bank sh.a., drejtuar subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk provon sa pretenduar nga subjekti. Referuar kësaj shkresë, konfirmimi *se banka nuk e ka të përcaktuar në procedurë nënshkrimin e mandatpagesës nga të gjithë pjesëmarrësit e palës së përshkruar në kontratë dhe faktit se depozitimi i fondeve mund të kryhet edhe nga njëri prej personave që janë pala porositëse*, nuk e përjashton subjektin nga detyrimi që ka pasur për të paguar pjesën e tij takuese sipas kontributit real financiar ose, më së paku, për të treguar kujdesin minimal si magjistrat për të detajuar në përshkrimin e transaksionit të kryer kontributin e tij, parë kjo edhe në kuadër të detyrimit të tij si subjekt deklarues për shkak të pozicionit që mbante në kohën e transaksionit.

1.1.2 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk solli asnjë provë të re gjatë gjykimit në Kolegj, për të provuar që kontributi i tij financiar ishte në masën 50% të çmimit të apartamentit me sip. 91.91 m<sup>2</sup>, por ngeli i provuar fakti që sipas transaksionit bankar, si dokument shkresor me vlerë të plotë provuese, më sipër ai ka paguar në shumën 57.250 euro, që i korrespondon rreth 78% të çmimit të apartamentit, shumë për të cilën nuk provoi as burimin e ligjshëm.

1.2 Për sa i përket *pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare të investimit të bashkëpronares \*\*\*. \*\*\*.*, edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit për kontributin financiar në masën 50% secili, *në vlerësimin e Komisionerit Publik*, pas verifikimit të prapësimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në seancat e datave 28.9.2023 dhe 4.10.2023, mbeti e paprovuar mundësia financiare e shtetases \*\*\*. \*\*\*. për krijimin dhe investimin e shumës së pretenduar, për sa më poshtë argumentuar:

1.2.1 *Mbi të ardhurat ligjshme të znj. \*\*\*. \*\*\*., nga punësimi.* Aktet e paraqitura nga subjekti në seancat e zhvilluara në Kolegj, mbi pagesën e detyrimeve tatimore për znj. \*\*\*. \*\*\*., në shtetin turk,<sup>1</sup> në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk provojnë të ardhurat e pretenduara në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. I njëjti përfundim rezultoi dhe nga vlerësimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, përkatësisht vërtetimet e pagave lëshuar nga punëdhënësi për \*\*\*. \*\*\*., depozituar pranë ILDKPKI mbi të ardhurat e kësaj shtetase, konfirmimin nga ISSH mbi të ardhurat për të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe lëvizjet/kreditimet e pagave në llogaritë bankare të kësaj shtetase.

1.2.1.1 *Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetases znj. \*\*\*. \*\*\*., nga punësimi, subjekti, në shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit depozituar në Komision, ka shpjeguar se: [.. kjo shtetase ( \*\*\*. \*\*\*) nuk ka qenë ndonjëherë dhe nuk është subjekt deklarimi. Ajo nuk ka pasur asnjë mundësi apo detyrim të dinte se mbi cilën shumë ishin derdhur kontributet e saj shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi... Që janë kryer me pagë minimale të kohës dhe jo sipas pagës së përfutur realisht. Në momentin që ka rënë në dijeni i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (do ju vendos në dispozicion vërtetimin e Gjykatës ). [...]* Komisionerit Publik, lidhur me faktin e marrjes dijeni dhe investimin e Gjykatës për çështjen në fjalë, i rezultoi se si në dosjen e KPK-së, edhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti nuk paraqiti asnjë provë të investimit të Gjykatës nga ana e znj. \*\*\*. \*\*\*.

<sup>1</sup> Në shkresën e Ministrisë së Turqisë nr. \*-\*\*\*-\*\*\*-\*\*-\*\*\* nuk specifikohet vlera e tatimit të paguar për periudhën 2010-2014; Në shkresën e Ministrisë së Turqisë nr. \*-\*\*\*-\*\*\*-\*\*-\*\*\* nuk specifikohet vlera e tatimit të paguar për periudhën \*\*\*.8.2009 - \*\*\*.1.2010.

1.2.2 Për sa i përket huas së pretenduar në shumën 8.000 euro, marrë nga shtetasja \*\*\*, \*\*\*, shtetases \*\*\*, \*\*\*, në vlerësimin e Komisionerit Publik, aktet e sjella nga subjekti në seancën e datës 28.9.2023, mbi burimet e shtetases \*\*\*, \*\*\*, për të krijuar shumën e pretenduar hua prej 8.000 euro, vërtetimi “Për bazën e vlerësuar” nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2022, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për periudhën maj 2012-2013, nuk provon mundësinë e saj për të mbuluar shumën e deklaruar dhënë hua. Aktet e vëna në dispozicion nga subjekti mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve të shtetases \*\*\*, \*\*\*, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk provojnë mundësinë e vetë shtetases \*\*\*, \*\*\* për dhënien e huas në shumën 8.000 euro.

1.2.3 Për sa i përket huas tjetër të pretenduar, në shumën 10.000 euro, marrë nga shtetasja \*\*\*, \*\*\*, shtetases \*\*\*, \*\*\*, në vlerësimin e Komisionerit Publik: (i) kjo marrëdhënie huaje nuk është deklaruar në D-Vetting dhe as në procesverbalin mbajtur në ILDKPKI, në datën \*\*\*.10.2014<sup>2</sup>, (ii) nuk provohet marrëdhënia e huas me akte të kohës; (iii) nga lëvizjet e llogarive bankare të shtetasit \*\*\*, \*\*\*, nuk evidentohet ndonjë transaksion që të lidhet me marrëdhënien e pretenduar të huas.

1.3 Për sa i përket *shkakut ankimor lidhur me huan marrë shtetasit \*\*\* \*\*\*, në vlerësimin e Komisionerit Publik, lidhur me sa trajtuar në ankim, për burimin e deklaruar të huadhënësit: të ardhurat nga kontrata e premtimit për shitje, datë 25.01.2013, ndërmjet huadhënësit \*\*\*, \*\*\*, dhe shtetases \*\*\*, \*\*\*, akti i paraqitur nga subjekti, shkresë e Ministrisë së Drejtësisë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2023, mbi informacionin lidhur me datën kur ka filluar punë, Regjistri Noterial Shqiptar provon prapësimet dhe pretendimet e subjektit mbi arsyet e mospasqyrimin të kontratës premtim shitje, datë \*\*\*.1.2013, të shtetasit z. \*\*\*, \*\*\*, në këtë Regjistër.*

1.3.1 Nga ana tjetër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë të re për të provuar e burimin e ligjshëm të huas së dhënë nga shtetasi \*\*\*, \*\*\*, prej 30.000 euro, si nga të ardhurat e biznesit, ashtu dhe nga ato personale.

1.3.2 Sa më sipër, sjellim në vëmendje të Kolegjit edhe faktin se kjo hua nuk rezultoi e deklaruar nga subjekti as në Deklaratën “Vetting” dhe as në përgjigje të procesverbalit të vitit 2014, pranë ILDKPKI-së, pyetur pikërisht mbi këtë çështje.

1.4 Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasurinë “**Apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>**”, në referencë të nenit D, pika 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

**2. Lidhur me shkakun ankimor gjetje në raportin e DSIK-së**, ku janë trajtuar vendime të marra nga subjekti në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, dhe konkretisht, vendim penal i gjyqtarit të seancës paraprake me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2019, vendim penal me nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2016, vendim civil nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2012, prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike të datës 28.9.2023 nuk

---

<sup>2</sup> I pyetur mbi aftësitë financiare të bashkëpronarit \*\*\*, \*\*\*, për blerjen e ap. 91.91 m<sup>2</sup> subjekti ka paraqitur vetëm vërtetimin e pagës së bashkëpronares, \*\*\*, \*\*\*.

sjellin ndryshim në qëndrimin e shprehur nga Komisioneri Publik, se shkeljet e evidentuara në mënyrë konkrete në ankimin e datës 21.2.2023, të Komisionerit Publik, lidhen me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin si nënindikator i parashikuar nga neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**3. Lidhur me shkakun ankimor gjetje në vlerësimin e aftësive profesionale**, objekt i të cilit janë dy vendime të marra nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht vendimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.12.2014, dhe vendimi me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.2015, të shqyrtuar në funksion të denoncimeve të shtetasës \*\*\*. \*\*\*. Subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësimet e tij në seancën gjyqësore publike të datës 28.9.2023, shoqëruar me aktin vendim nr. \*\*\*, datë \*\*\*.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër, me objekt: “*kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Arbër Çela...*”, vendim ky që sqaron rrethanat në të cilat është marrë vendimi i datës \*\*\*.12.2014 dhe sqaron/shëron mangësinë e evidentuar në pikën 21.10 të ankimit, të datës 21.2.2023, të Komisionerit Publik. Mangësitë e tjera të evidentuara për këtë shkak ankimor qëndrojnë siç janë parashtruar në seancën e datës 28.9.2023.

## **II. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

**4.** Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**